

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/285/2017  
Datë: 01/12/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në takimin e shtatë të përbërjes së parë, të mbajtur më 01 dhjetor 2017 merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja Nr. 08/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*A. Lumezi*  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Udhëheqësit të PTF-së  
Udhëheqësit të PTV-së  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë /Akademija Pravde /Academy of Justice*

---

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në pajtim me nenin 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenit 24 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 01.12.2017,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 08/2017**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.06/2017 PËR  
TRAJNUESIT DHE MENTORËT E AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

**Neni 2**

Neni 14 i Rregullores bazë, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, ndryshohet si në vijim:

1.1 Të jenë gjyqtar dhe prokurorë të shtetit me mandat të përhershëm në Departamentin e Përgjithshëm. Në rast të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve apo prokurorëve të shtetit në Departamentin e Përgjithshëm, mentorë mund të caktohen edhe gjyqtarët apo prokurorët e shtetit të Departamentit të Krimeve të Rënda. Nëse gjyqtarët e sapoemëruar caktohen në Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike të Gjykatës Themelore, mentor mund të caktohen edhe gjyqtarët që punojnë në këto departamente.


**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Prishtinë, 01.12.2017



Aleksandër Lumezi

  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë